



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETESE**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE**

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/ 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 3**  
**( NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

(17.05.2024)

**Drejtuar: OPERATORIT EKONOMIK “POWER INDUSTRIES” shpk**

**Adresa:** Tiranë, Vore PICAR, Zona Kadastrale Nr.3974, Volumi5, Faqe 143, Sip. Totale 2610 m<sup>2</sup>.

Procedura e prokurimit/lotit **Procedure e Hapur, Mallra.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Blerje Motorre për Policinë Bashkiake” me Nr. reference REF-REF-86840-11-08-2023**, për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini Nr. 93 datë 13 Nëntor 2023 si dhe Buletini Nr.24 datë 13 Maj 2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- **Operatori ekonomik “POWER INDUSTRIES” shpk me NUIS L51706022H**

Vlera e ofertës pa tvsh = 12.365.100 (dymbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind) lekë.

- **Operatori ekonomik “MOTO TIRANA” shpk me NUIS K21512004G**

Vlera e ofertës pa tvsh = **13.200.000** (trembëdhjetë milion e dyqind mijë) lekë.

- **Operatori ekonomik “Moto Italia” shpk me NUIS M22129019P**

Vlera e ofertës pa tvsh = **13.651.000** (trembëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

## 1. Operatori ekonomik “Moto Italia” shpk me NUIS M22129019P

*Për arsyet e mëposhtme:*

**Autoriteti Kontraktor në pikën 2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të dokumentave standarde të tenderit, përcakton se:**

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*“2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:*

*Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8”.*

Në referencë të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, pika 2, shkronja (c), AK përcakton “Ofertuesi **deklaron se:** ... c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose **ortakut**, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së”;

Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga Operatori Ekonomik “Moto Italia” shpk dhe konkretisht nga verifikimi i “Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit”, sipas Shtojcës 8, rezulton se:

Operatori ekonomik si më sipërcituar nuk ka deklaruar ortakun “Kristjan Çuni” ndërkohë që ka cilësuar si të tillë Znj. Alba Halili e cila në ditën e hapjes së ofertave dt 29.03.2024 nga verifikimi i ekstraktit historik tregëtar nuk është më ortakë e shoqërisë pasi referuar të dhënave të këtij ekstrakti është bërë kalimi/dhurimi i 50% të kuotave të shoqërisë nga ortaku Alba Halili në favor të Z.Kristjan Çuni në cilësinë e ortakut të kësaj shoqërie.

Formulari përmbledhës i vetdeklarimit i paraqitur në SPE nga ana e operatorit ekonomik si më sipër cituar mban si datë dorëzimi datën 04.12.2023 datë kjo e vendosur pas modifikimit të bërë nga Njësia e Prokurimit lidhur me disa specifikime teknike. Pas modifikimit të specifikimeve teknike ka patur një proces ankimi dhe pas përfundimit të tij është bërë sërish një modifikim i specifikimeve teknike duke u bërë edhe shtyrja e datës për hapjen e ofertave në datë 29.03.2024. Në datën 04.12.2023 që mban formulari i vetdeklarimit të paraqitur nga OE si më sipërcituar ortak i shoqërisë ka figuruar Znj. Alba Halili pasi kalimi i kuotave është bërë në dt.01.02.2024 ndërkohë që ofertuesi “Moto Italia” shpk duhet të kishte marrë masat për të kryer përditësimet tek formulari përmbledhës i vetdeklarimit duke qënë se shtyrja e datës së hapjes shapjes së ofertave ishte për në dt 29.03.2024. Operatori ekonomik mund ta përdorte këtë formular vetëdeklarimi vetëm nëse informacioni që përmban do të vazhdonte të ishte i saktë dhe i vlefshëm deri në ditën e hapjes së ofertave në rast të kundërt duhet ta përditësonte gjë e cila nuk ka ndodhur.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Duke qënë se AK pranon si provë

paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta formularin përmbledhës të vetdeklarimit sipas përcaktimit në nenin 82 të LPP-së dhe RRPP-së referuar vetdeklarimit të OE i cili mban datën 04.12.2023 i gjithë informacioni i deklaruar në të si: OSSHE, listpagesat etj..., nuk është i vlefshëm në ditën dhe orën e hapjes së ofertave konkretisht dt 29.03.2024.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80, nenit 92, pika 3, të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar) Neni 79, neni 80, neni 82, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## **2. Operatori ekonomik “MOTO TIRANA” shpk me NUIS K21512004G**

### Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik Moto Tirana shpk nuk plotëson specifikimet teknike sipas shtojcës Nr.5 të modifikuar. Referuar dokumentacionit të paraqitur në SPE nga OE Moto Tirana shpk rezulton se OE ka dorëzuar një dokument me emërtim “Pranimi i specifikimeve teknike” me anë të të cilit deklaroi se pranon specifikimet teknike sipas kërkesave të AK si dhe Formularin e vetdeklarimit sipas File me emërtim “Moto Tirana\_Shtojca 8”, Pjesa III/A në të cilën deklaroi se “Në cilësinë e operatorit ekonomik, plotësojmë të gjitha specifikimet teknike sic udhëzohet në dokumentat e tenderit .....” ndërkohë referuar katalogut të paraqitur në përmbushje të kërkesës “Kapaciteti teknik dhe profesional” pika 2.3.4, Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë ku të përshkruhen specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi në përputhje me ato të kërkuara nga AK. Në katalogë/broshurë duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike sipas atyre të përcaktuara në shtojcën 5 të DST. Specifikimet teknike të markës edhe modelit të ofertuar do të krahasohen me specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre. Fleta ose fletët e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara duhet të paraqiten në gjuhën shqipe të përkthyer dhe noterizuara”, katalogu i paraqitur sipas file me emërtim “MARRËVESHJA PËR DISTRIBUTOR DHE FRAGMENT BROSHURE” jo vetëm është i paqartë por vihet re se të dhënat /fragmentet e përkthyer në gjuhën shqipe nuk përmbushin të gjitha specifikimet teknike referuar shtojcës për modifikim të specifikimeve teknike të datës 21.03.2024 të publikuar në SPE. Nga katalogu rezulton se nuk ka asnjë të dhënë teknike lidhur me 3 elementë/të dhëna teknike të rëndësishme: 1. Fuqia motorike: min 50KË; 2. Konsumi karburantit: 4 L-5L/100 km; 3. Emisioni Euro 5.

KVO dhe pas shqyrtimit të katalogut të ngarkuar në SPE nga OE ka kryer verifikimet dhe në faqen elektronike të modelit të ofertuar dhe rezultoi se as në katalogun online nuk rezultojnë këto të dhëna të cilat janë të rëndësishme dhe duhet të plotësohen për sa kohë janë kërkuar nga AK.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 80, nenit 92, pika 3, të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020, për “Prokurimin Publik”, dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar) Neni 79, neni 80, neni 82, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “POWER INDUSTRIES” shpk**, me adresë: Tiranë, Vore PICAR Tiranë, Picar, Zona Kadastrale Nr.3974, Volumi5, Faqe 143, Sip. Totale 2610 m2, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 12.365.100 (dymbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëqind) lekë pa tvsh, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë me adresë Sheshi “Skënderbej”*, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_